



Analizë

RASTI KLEÇKA: KA FITUAR LIGJSHMËRIA, POR JO DREJTËSIA

Hyrje

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me trupin gjykues në përbërje të përzier, me të cilin ka kryesuar gjykatësi ndërkombëtar Jonathan Wilford-Carroll¹, në datën 2.05. 2012 ka shpallur vendimin gjyqësor, me të cilin ish pjesëtarët e UÇK-së Fatmir Limaj², Naser Krasniqi, Nexhmi Krasniqi dhe Naser Shala lirohen nga të gjitha akuzat për krime të luftës, me të cilat i ka ngarkuar aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) e datës 25.07. 2011. Me këtë aktakuzë, Limajt dhe të bashkakuarve³ të tij i vihet në barrë kryerja e veprave penale *krime të luftës kundër popullatës civile* dhe *krime të luftës kundër të burgosurve të luftës*, sipas disa pikave. Me vendimin gjyqësor të datës 2.05. 2012, ka përfunduar në tërësi procedura e shkallës së parë në gjykimin më të madh dhe më të rëndësishëm për krime të luftës në Kosovë në vitin 1999. Me fjalë të tjera, gjykimi në këtë lëndë është zhvilluar kundër dhjetë personave, por gjykata, me një vendim më të hershëm të shpallur në datën 30.03. të vitit 2012, nga aktakuza e ka liruar Arben Krasniqin, Behlul Limajn, Refki Mazrekun, Sabit Shalën dhe Shaban Shalën. Gjykimi formalisht është zhvilluar me emrin *Prokurori kundër Arben Krasniqit dhe të tjerëve*, por në opinionin e gjerë ka qenë i njohur si rasti „Kleçka“ ose rasti "Limaj dhe të tjerët".

Dy vendimet gjyqësore, me të cilat lirohen të akuzuarit, kanë qenë rezultat logjik pas vendimit të gjykatës gjatë seancës kryesore të kumtuar në datën 21.03. 2012 për të shpallur të papranueshme provat e dëshmitarit bashkëpunues, i cili në lëndë është i prezantuar si „Dëshmitari X“⁴. Aktakuza, të cilën e ka

¹ Anëtarët e trupit gjykues: gjykatësi ndërkombëtar Dean Pinales dhe gjykatësja vendore Shqipe Qerimi.

² Një nga komandantët e UÇK-së në zonën e Drenicës në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë; zëvendës i Ministrit të Mbrojtjes në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, të formuar pas luftës nga ana e partive shqiptare; Ministër i Transportit në qeverinë e Kosovës në vitet 2007-2010. Në fazën e fillimit të procedurës penale ka qenë nënkryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe deputet i Kuvendit të Kosovës; pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të datës 22.09.2011 lirohet nga imuniteti i deputetit.

³ Naser Krasniqi, Nexhmi Krasniqi, Behlul Limaj, Fatmir Limaj, Refki Mazreku, Naser Shala, Sabit Shala, Shaban Shala dhe Besim Shurdhaj.

⁴ Identiteti i dëshmitarit një kohë të gjatë është ruajtur nga publiku dhe në materialet e lëndës është paraqitur si “Dëshmitari X”. Megjithatë, pasi që ky dëshmitar më nuk është në jetë, është zbuluar se është fjala për pjesëtarin e dikurshëm të UÇK-së, Agim Zogajn, i cili ka vepruar në qendrën e paraburgimit në fshatin Kleçkë. Raporti i referohet këtij dëshmitari sipas emrit me të cilin ai është paraqitur në aktakuzë.



përfaqësuar prokurori i EULEX-it Maurizio Salustro, pothuajse në tërësi ka qenë e bazuar në deklaratat dhe provat materiale, të cilat ia ka siguruar prokurorisë “Dëshmitari X”. Për këto arsye, Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë në vazhdim të tekstit i kushton vëmendje të veçantë analizës së vendimit të gjykatës që nga duart e prokurorisë të heq argumentin kryesor për ndjekjen penale të ish komandantit të lartë të UÇK-së Fatmir Limajt dhe nëntë pjesëtarëve të UÇK-së, të cilët kanë qenë vartës të Limajt.

(Pa)pranueshmëria e provave të „Dëshmitarit X“

Duke vepruar sipas vërejtjeve të shumta të mbrojtjes së të akuzuarve të dhëna me gojë gjatë seancës kryesore dhe në formën me shkrim, si dhe pas sigurimit të përgjigjes së prokurorit ndaj vërejtjeve të paraqitura, gjykata, me vendimin e datës 21.03.2012, i ka shpallur të papranueshme deklaratat e „Dëshmitarit X“ të dhëna gjatë hetimeve policore dhe të prokurorisë në cilësinë e të dyshuarit dhe të dëshmitarit bashkëpunues. Të papranueshëm janë shpallur edhe ditarët e tij. Të gjitha këto prova, përndryshe, janë shpallur prova të pranueshme me vendimin e konfirmimit të aktakuzës të datës 26 gusht të vitit 2011, të cilat i ka sjellë gjykatësi për konfirmimin e aktakuzës⁵.

Që nga vet fillimi i seancës kryesore në lëndën „Kleçka“ (11.11.2011.) mbrojtja e të akuzuarve⁶ para gjykatës ka filluar të paraqes një numër të madh vërejtjesh me të cilat e ka kundërshtuar pranueshmërinë e deklaratave të "Dëshmitarit X", të cilat ai i ka dhënë në fazat e mëhershme të procedurës dhe në cilësi të ndryshme. Edhe pse, me iniciativën e prokurorit, ka qenë i mundur ballafaqimi me dëshmitarin bashkëpunues dhe kundërshtimi i deklaratave të tij me të cilat i ngarkon klientët e tij, mbrojtja ka bërë vërejtjet e saj lidhur me mundësinë e përmendur të dëgjimit të dëshmitarit bashkëpunëtor duke pohuar se në atë periudhë: nuk e ka pasur qasjen adekuate ndaj materialeve të lëndës; se nuk ka pasur kohë të mjaftueshme të njihet me dokumentacionin dhe që në mënyrë të duhur të përgatitet për dëgjimin e dëshmitarit bashkëpunues; se prokurori është dashur sërish të dëgjoj dëshmitarin bashkëpunues në praninë e tyre kur „Dëshmitarit X“ i është përcaktuar ky status ose që dëshmitari bashkëpunues të dëgjohet nga ana e gjykatësit të procedurës paraprake në pajtim me nenin 238 të LPPK. Të gjitha këto kanë qenë fakte të cilat e kanë shtyrë mbrojtjen të arrijë te përfundimi se prokurori, në këtë mënyrë, ka dashur vetëm të instrumentalizojë mbrojtjen me qëllim që t'i ndihmojë në kryerjen e obligimeve statusore. Mbrojtja, për këtë arsye, ka pohuar para gjykatës se dëgjimi i dëshmitarit bashkëpunues ka qenë i kufizuar në pikëpamje

⁵ Gjykatësi ndërkombëtar Ingo Richs.

⁶ Posaçërisht gjatë seancave të gjykatës të mbajtura në datën: 28., 29.02; 1., 6., 7.03.2012.



kohore dhe funksionale si dhe se nuk ka pasur mundësi për ballafaqimin adekuat dhe të duhur të saj me dëshmitarin.

Në përgjigjen me shkrim lidhur me vërejtjet e mbrojtjes të dorëzuar në datën 12.03.2012, prokuroi ka theksuar: se mbrojtja e obliguar qartazi është e paraparë me ligj kur nga i akuzuari kërkohet për ta pranuar fajësinë; se „Dëshmitari X“ në momentin kur e ka fajësuar vetveten dhe të tjerët për ngjarjet, të cilat janë zhvilluar në Kleçkë, komuna e Lipjanit, në pranverën e vitit 1999, e ka pasur statusin e të dyshuarit; si dhe se kundër „Dëshmitarit X“ kurrë nuk është ngritur aktakuzë. Prokurori në mënyrë të posaçme ka theksuar se nuk ka pasur as lëshime procedurale me rastin e dhënies së urdhit mbi shpalljen e „Dëshmitarit X“ dëshmitar bashkëpunues, dhënies së deklaratave të tij si dhe as në faktin se dëshmitari bashkëpunues nuk e ka nënshkruar çdo faqe të deklaratave të tij si dhe se në seancën e datës 24.08.2010, në të cilën është shqyrtuar propozimi i prokurorit mbi shpalljen e „Dëshmitarit X“ dëshmitar bashkëpunues, gjatë të cilës „Dëshmitari X“ nga anash është përkujtuar nga gjykatësi i procedurës paraprake se si dëshmitar është i obliguar të flas të vërtetën. Aso kohe, sipas prokurorit, „Dëshmitari X“ i ka vërtetuar të gjitha deklaratat e tij të mëparshme si të sakta. Sipas prokurorit, mbrojtjes nuk i është kundërshtuar mundësia e qasjes ndaj materialeve të lëndës, dhe prokurori, sipas ligjit, nuk është i obliguar që mbrojtjes t’ia sigurojë kopjet e këtyre materialeve. Para seancës së konfirmimit të aktakuzës, mbrojtjes i është dorëzuar dokumentacioni, mbi të cilin është bazuar aktakuza, krahas faktit se disa dokumente të veçanta kanë qenë të redaktuara për arsye se kanë pasur të bëjnë me identitetin e dëshmitarëve individual të mbrojtur ose me disa hetime të ardhshme.

Sipas gjetjeve të gjykatës, dosja e gjithmbarshme e prokurorisë në lëndën „Kleçka“ bazohet në deklaratat dhe provat materiale të një dëshmitari, i cili, njëkohësisht, edhe ka qenë bashkëkryerës i veprave penale, me të cilat të akuzuarit ngarkohen dhe i cili ka qenë një nga të dyshuarit në hetimet, të cilat janë zhvilluar në këtë lëndë. „Dëshmitari X“, ish pjesëtar i UÇK-së, sipas fjalëve të tij, nga ana e Fatmir Limajt ka qenë i emëruar për mbikëqyrës të të burgosurve në qendrën e paraburgimit, e cila ka qenë vendosur në një shtëpi private në fshatin Kleçkë, komuna e Lipjanit. Sipas pohimeve të dëshmitarit bashkëpunues, gjatë luftës, detyrimet e tij në qendrën e paraburgimit kanë qenë që, krahas obligimeve të tjera, të mbajë evidencën e të burgosurve, me të cilët çdo ditë ka qenë në kontakt. Dëshmitari bashkëpunues ka mbajtur ditar për aktivitetet e tij si dhe për aktivitetet e UÇK-së, në të cilin çdo ditë ka përshkruar ngjarjet në qendrën e paraburgimit.

Statusi i „Dëshmitarit X“, sipas gjetjeve të gjykatës, gjatë procedurës ka ndryshuar. Para hetuesve për krime të luftës, ai, nga fundi i vitit 2009, ka dëshmuar në cilësi të dëshmitarit, pas vënies së kontaktit, sipas iniciativës së tij, me policinë e EULEX-it. Gjatë vitit 2010, „Dëshmitari X“ ka dhënë shumë deklaratat para



prokurorit, së pari në cilësi të të dyshuarit⁷, në mënyrë që, pas urdhrit të gjykatësit të procedurës paraprake të datës 25.08.2010, t'i caktohet statusi i dëshmitarit bashkëpunues. Në muajin korrik të vitit 2011⁸, mbrojtjes së të akuzuarve iu është dhënë mundësia që, në pajtim me rezultatet e deriatëhershme të hetimeve, tërthorazi ta hetojnë dëshmitarin bashkëpunues.

Duke e arsyetuar vendimin mbi papranueshmërinë e provave, të cilat i ka siguruar “Dëshmitari X”, gjykata, si lëshim kryesor të prokurorisë e ka konstatuar atë se para ofrimit të mbrojtjes mundësinë e dëgjimit të dëshmitarit bashkëpunues në muajin korrik të vitit 2011, avokatëve të të akuzuarve nuk ia ka dorëzuar dokumentacionin e plotë nga hetimet e deriatëhershme, të cilat janë zhvilluar lidhur me rastin „Kleçka“, e para së gjithash të ashtuquajturin ‘ditarin e luftës’ të dëshmitarit bashkëpunues si dhe deklaratat e personave, të cilët deri atëherë janë dëgjuar si dëshmitar. Sipas gjetjeve të gjykatës, disa materiale të veçanta të lëndës kanë qenë të redaktuara, kurse një pjesë e dokumentacionit i është dorëzuar mbrojtjes dhe të akuzuarve vetëm pasi që avokatët e mbrojtjes kanë pasur rast të ballafaqohen me dëshmitarin bashkëpunues dhe tërthorazi ta hetojnë si dhe që përkthimet e disa materialeve të veçanta të lëndës i janë dorëzuar mbrojtjes vetëm në muajin janar të vitit 2012, disa muaj pas fillimit të gjykimit. Në këtë kontekst, gjykata ka konstatuar se edhe në materialet e lëndës ekziston dokumentacioni mbi të cilin gjykata nuk e posedon evidencën lidhur me atë se kur i është dorëzuar ai mbrojtjes.

Sipas gjetjeve të gjykatës, mundësia e hetimit të dëshmitarit bashkëpunues nga ana e mbrojtësve të të akuzuarve, deri tek e cila është arritur gjatë muajit korrik të vitit 2011, është larg nga standardet, të cilat parashihen me Ligjin mbi Procedurën Penale. Me fjalë të tjera, mbrojtjes nuk i është dhënë mundësia e përgatitjes adekuate për dëgjimin e dëshmitarit bashkëpunues, sepse ajo nuk e ka poseduar dokumentacionin e nevojshëm nga dosja e lëndës (duke përfshirë edhe deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues të dhëna hetuesve të Trbunalit të Hagës) ashtu që në mënyrë adekuate të përgatitet për hetimin e “Dëshmitarit X”.

Gjykata ka konstatuar se në kohën kur iu është ofruar mundësia e hetimit të dëshmitarit bashkëpunues, gjatë muajit korrik të vitit 2011, avokatët e mbrojtjes nuk kanë qenë në posedim të 41 deklaratave të dëshmitarëve, të cilat i posedonte prokuroria. Mbrojtja, madje, as nuk ka qenë e njohur mbi arsyen e organizimit të seancave në të cilat ka pasur mundësi për ta hetuar dëshmitarin bashkëpunues. Gjykata, me këtë rast, lidhur me këtë, duke iu referuar nenit 7, paragrafit 2 të LPPK, ka konstatuar se prokurori është i

⁷ Personi, për të cilin policia ose organet e ndjekjes në mënyrë të arsyetuar dyshojnë se ka kryer vepër penale por kundër të cilit nuk ka filluar procedura penale- neni 151, paragrafi 1 i LPPK. I dyshuari, gjatë këtyre dëgjimeve nga ana e prokurorit të lëndës është udhëzuar mbi të drejtat e tij si i pandehur në pajtim me nenin 31 të LPPK. Sipas nenit 151 të LPPK, "i pandehuri" është personi kundër të cilit zhvillohet procedura penale. Shprehja i pandehur po ashtu përdoret në LPPK si emër i përgjithshëm për të pandehurin, të akuzuarin dhe të gjykuarin.

⁸ Në datën: 5., 6., 7., 9 korrik të vitit 2011.



obliguar t'ia vë në dispozicion mbrojtjes të gjitha provat, të cilat janë në dëm ose në dobi të të akuzuarve, në mënyrë që mbrojtja të përgatitet sa më mirë për hetimin e dëshmitarit kyç, mbi deklaratat e të cilit është bazuar aktakuza dhe i cili, në të njëjtën kohë, ka qenë bashkëkryerës i veprave penale me të cilat ngarkohen të akuzuarit e tjerë. Në këtë fazë të procedurës, mbrojtja, në bazë të ligjit, ka të drejtë që dëshmitarit ti shtrojë pyetje në të njëjtin nivel si edhe me rastin e seancës kryesore. Në rastin konkret, avokatët e mbrojtjes nuk kanë pasur mundësi ta shfrytëzojnë këtë të drejtë.

Sipas gjetjeve të gjykatës, prokurori nuk e ka përmbushur obligimin ligjor ndaj mbrojtjes. Dëgjimi i dëshmitarit bashkëpunues në atë fazë është dashur të kryhet në mënyrën se si parashihet me nenin 238 paragrafi 1 i LPPK⁹ në bazë të të cilit ballafaqimi i mbrojtjes me dëshmitarin dhe hetimi i dëshmitarit nga ana e tyre bëhet para gjykatësit të procedurës paraprake në prani të të gjitha palëve në procedurë, ku prokurori prapë do t'i shtronte pyetje dëshmitarit bashkëpunues, dhe pas të cilave do të pasonin pyetjet e mbrojtjes lidhur me deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues.

Sipas gjetjeve të gjykatës, me dhënien e mundësisë mbrojtjes për dëgjim të dëshmitarit sipas nenit 156, paragrafi 2 i LPPK, nuk plotësohen kushtet në pajtim me nenin 238 të LPPK, me të cilin do të mund të zëvendësohej dëgjimi i dëshmitarit para trupit gjykues, sepse me nenin 8, paragrafi 2 i LPPK, është përcaktuar që trupi gjykues vendimin mund ta marrë vetëm në bazë të provave të nxjerra dhe të konfirmuara në seancën kryesore.

Gjykata nuk e ka pranuar qëndrimin e prokurorisë sipas të cilit, për hir të shpalljes së të dyshuarit dëshmitarë bashkëpunues, ka qenë e domosdoshme që kundër tij të zhvillohen hetime dhe të dëgjohet para prokurorit në cilësinë e të dyshuarit apo të të pandehurit. Ligji mbi procedurën penale e parasheh që dëshmitari bashkëpunues mund të shpallet i dyshuar ose i pandehur, kundër të cilit ende nuk është lexuar

⁹ Neni 238, paragrafi 1.: „Prokurori publik ose i padituri munden, përjashtimisht, që nga gjykatësi i procedurës paraprake të kërkojnë ta dëgjojnë dëshmitarin ose të kërkojnë mendimin e ekspertit me qëllim të ruajtjes së provave kur ekziston mundësia unike që të sigurohet një provë e rëndësishme ose kur ekziston rreziku i madh se ajo provë nuk do të jetë më vonë në dispozicion gjatë hetimeve. Kundër vendimit të gjykatësit të procedurës paraprake, me të cilin ai refuzon kërkesën për marrjen e provës së tillë, mund të paraqitet ankesa e trupit gjykues tre anëtarësh.“

Paragrafi 2: „Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, gjykatësi i procedurës paraprake ndërmerr masat e duhura për sigurimin e efikasitetit dhe të integritetit të procedurës e posaçërisht për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij/saj dhe prokurori publik janë të pranishëm në dëgjimin për marrjen e deklaratave. I dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij/ saj ligjor ose avokati do të jenë të informuar mbi dëgjimin dhe e kanë të drejtën për të qenë të pranishëm. Dhënia e deklaratave gjykatësit të procedurës paraprake bëhet në pajtim me dispozitat e kapitujve XX, XXI, XXII të këtij ligji në lidhje me dëshmitarët dhe ekspertët.“

Paragrafi 3: „Neni 165 zbatohet me përshtatjen përkatëse dhe në hetimin e dëshmitarëve dhe të ekspertëve “



aktakuza e prej të cilit pritet se mund të dëshmojë gjatë seancës¹⁰. Gjykata ka qëndruar në pikëpamjen se nuk ka qenë e domosdoshme që “Dëshmitari X” të dëgjohet në cilësinë e të dyshuarit, sepse prokuroria qysh nga hetimet policore ka pasur mjaft informacione dhe baza për ta shpallur dëshmitar bashkëpunues. Sipas gjetjeve të gjykatës, nuk ka qenë e domosdoshme që prokurori, me anë të dëgjimit në cilësinë e të dyshuarit, edhe njëherë të vërtetojë deklaratat e tij, të cilat ai, si dëshmitar, ia ka dhënë sektorit të policisë të obliguar për hetimin e krimeve të luftës, me të cilin, përndryshe, “Dëshmitari X” me vetiniciativë është vënë në kontakt, në mënyrë që, sipas fjalëve të tij, të mbrohej nga sulmet e mundshme dhe që të parandaloj pasojat fatale.

Sipas gjetjeve të gjykatës, një nga lëshimet e mëdha të prokurorit është se edhe pas lëshimit të urdhrimit mbi shpalljen e dëshmitarit bashkëpunues, nga i njëjti ai nuk ka kërkuar ta vërtetojë saktësinë e pohimeve në deklaratat e tij, të cilat i ka dhënë në cilësinë e të dyshuarit, kur, sipas ligjit mundet dhe edhe nuk është i detyruar të përgjigjet, mundet dhe nuk është i detyruar të thotë të vërtetën, që nuk është rasti kur dëgjohet në cilësinë e dëshmitarit, përkatësisht të dëshmitarit bashkëpunues, kur në mënyrë obliguese ceket se dhënia e deklaratave të rrejshme përfaqëson vepër penale¹¹. Gjykata nuk e ka pranuar qëndrimin e prokurorit se në procedurën e dhënies së urdhrimit, në datën 24.08.2010, këtë e ka bërë gjykatësi i procedurës paraprake kur, sipas pohimeve të prokurorit, dëshmitari bashkëpunues i ka vërtetuar si të vërteta të gjitha deklaratat, të cilat gjatë kësaj procedure i ka dhënë në cilësinë e dëshmitarit dhe të të dyshuarit.

Dëshmitari bashkëpunues, pas ngritjes dhe konfirmimit të aktakuzës si dhe gjatë fazës së përgatitjes për fillimin e seancës kryesore, ka kryer vetëvrasje në rrethana të pasqaruara në Gjermani në datën 28.09.2011

¹⁰ Neni 298 i LPPK: „Dëshmitar bashkëpunues është i dyshuari ose i pandehuri në lidhje me të cilin aktakuza ende nuk është lexuar në seancën kryesore dhe prej të cilit pritet që gjykatës t’ia paraqes provat:

paragrafi 1: që me gjasë do të parandalojnë që një person tjetër të kryejë vepër penale;

paragrafi 2: që me gjasë do të çonin drejt zbulimit të së vërtetës në procedurën penale;

paragrafi 3: që janë të dhëna me pajtimin e plotë me qëllim që të dëshmuarit në gjykatë të jetë i besueshëm;

paragrafi 4: për të cilat gjykata vendos se janë të besueshme dhe të plota ose

paragrafi 5: që do të mund të çonin drejt ndjekjes së suksesshme të kryerësve të tjerë të veprave penale.

¹¹ Neni 164, paragrafi 2 i LPPK: „Së pari i thuhet dëshmitarit se është i obliguar ta thotë të vërtetën dhe se nuk guxon asgjë të mbajë të fshehur, dhe pas këtyre i tërhiqet vërejtja se të dëshmuarit e rrejshëm përbënë vepër penale. Po ashtu, dëshmitari udhëzohet se nuk është i obliguar të përgjigjet në cilëndo prej pyetjeve, parapare në nenin 162 të këtij ligji (se nuk është i obliguar të përgjigjet në pyetje të veçanta nëse ka gjasë se me ato përgjigje do të shkaktonte turpërim, dëm të konsiderueshëm material ose do t’ia ekspozonte veten ndjekjes penale ose kushëririt të tij të afërm; gjykata do ta informojë dëshmitarin mbi këtë të drejtë), udhëzimi futet në procesverbal.



dhe, me këtë, përfundimisht ka humbur mundësia e dëgjimit të tij para trupit gjykues. Edhe pse disa materiale të veçanta të lëndës (deklaratat e dëshmitarëve të caktuar dhe të ish të burgosurve¹²) deri diku i vërtetojnë pohimet e dëshmitarit bashkëpunues, vdekja e dëshmitarit kyç ka sjellë deri tek rrethanat rënduese në pikëpamje të mundësisë së vazhdimit të seancës kryesore, sepse sipas gjetjeve të trupit gjykues në materialet e lëndës nuk ka prova, të cilat mundën qartazi të vërtetojnë pohimet e tij.

Dhe në fund, gjykata ka konstatuar se gjatë dëgjimit të "Dëshmitarit X" nga e ana e prokurorit nuk është respektuar as neni 89, paragrafi 2 i LPPK, i cili e obligon personin, i cili dëgjohet, që në mënyrë obligative të nënshkruhet në secilën faqe të deklaratës, e cila është më e gjatë se një fletë, gjë që nuk ka ndodhur me deklaratat e "Dëshmitarit X" dhe, në këtë mënyrë, deklaratat ashtu të mbledhura, nuk kanë qenë të pranueshme për gjykatën.

Sipas gjetjeve të gjykatës, të gjitha lëshimet e cekura të prokurorisë kanë pasur efekt kumulativ në heqjen e të drejtës mbrojtjes që ajo, në mënyrë efikase, ta luajë rolin e saj gjatë procedurës parapenale, gjë që prokurorisë ia ka krijuar përparësinë në raport me avokatët e hendikepuar të mbrojtjes.

Vërejtjet e mbrojtjes ndaj provave të „Dëshmitarit X“, të cilat gjykata nuk i ka pranuar

Gjykata nuk i ka pranuar vërejtjet e mbrojtjes mbi papranueshmërinë e deklaratave të "Dëshmitarit X" të dhëna policisë së EULEX-it në gjysmën e dytë të vitit 2009, sepse këto deklarata janë marrë para hapjes së hetimeve me anë të vendimit mbi hapjen e të njëjtave. Nenet 200 dhe 201 të LPPK e autorizojnë policinë që të ndër marrë veprime dhe masa në atë mënyrë me të cilën do të parandalohet fshehja e provave dhe, nga këto arsye, deklaratat e „Dëshmitarit X“ të dhëna policisë, sipas pikëpamjes së gjykatës, përbëjnë prova të pranueshme.

Gjykata ka konstatuar se nuk janë të bazuara as vërejtjet e mbrojtjes që kanë pasur të bëjnë me rrethanën se "Dëshmitari X" nuk ka pasur mbrojtës në fazën e pranimin të fajit. Gjykata këtë konstatim e bazon në nenin 73, paragrafi 1 i LPPK, i cili qartazi e rregullon çështjen e mbrojtjes së obliguar. "Dëshmitari X" në asnjë moment gjatë procedurës nuk ka hyrë në fazën e marrëveshjes mbi pranimin e fajit, kështu që, sipas gjykatës, prania e avokatit nuk ka qenë e obliguar. Po ashtu, të pabazuara, sipas gjykatës, janë treguar edhe pohimet e mbrojtjes se prokurori nuk e ka kryer vëzhgimin psikiatrik të "Dëshmitarit X" gjatë hetimeve të prokurorisë, sepse nuk ka prova se "Dëshmitari X" gjatë dëgjimeve të kryera gjatë vitit 2010 ka treguar shenja të çrregullimit psikologjik ose të paaftësisë që vet me sukses të mbrohet.

¹² Vërejtje e vëzhguesit të FDH Kosovë në bazë të dokumentacionit gjyqësor të rastit, të cilin ia ka dalë ta sigurojë.



Gjykata nuk i ka pranuar as vërejtjet e mbrojtjes se prokuroria nuk ia ka tërheq vërejtjen me kohë “Dëshmitarit X” se deklaratat e tij mund të jenë të përdorura në gjykatë. Edhe pse neni 231 paragrafi 2, pika 5 e LPPK e parasheh se prokurori, me rastin e dëgjimit të të pandehurit, duhet detyrimisht ta njoh me faktin se deklarata e tij do të jetë e përdorur para gjykatës, në rastin konkret kanë qenë të qarta rrethanat dhe qëllimi se deklaratat e tij do të jenë të përdorura para gjykatës, sepse ato janë dhënë me atë qëllim. Sipas gjetjeve të gjykatës, rrethana e cekur nuk përfaqëson shkelje të tillë të ligjit, për shkak të së cilës një deklaratë duhej të shpallej e papranueshme.

Qëndrimi i FDH Kosovë lidhur me shpalljen të papranueshme të provave të „Dëshmitarit X”

1. Vendimi i gjykatës për të shpallur të papranueshëm të dëshmuarit dhe provat materiale të „Dëshmitarit X” është i bazuar në ligj. Me këtë vendim, Trupi gjykues penal, në krye me gjykatësin e EULEX-it Jonathan Wilford-Carroll ka demonstruar respektimin e njërit prej parimeve kulminante të së drejtës penale ndërkombëtare, që siguron gjykimin e drejtë dhe barazinë e palëve gjatë gjithë procedurës, si gjatë procedurës penale, ashtu edhe gjatë veprimeve të procedurës paraprake. Pikëpamja e gjykatës se e drejta në gjykimin e ndershëm, përkatësisht në të drejtën në mbrojtjen e plotë dhe të papenguar ka qenë e limituar me veprimet procedurale të prokurorisë gjatë procedurës paraprake mund të shërbejë si një përvojë e çmuar për gjykatësit kosovar në tretmanin e barabartë të të gjitha palëve në procedurë, pavarësisht nga pesha e veprës penale, imperativi që ajo të sqarohet dhe ndriçohet, si dhe dyshimi i bazuar që lidhet me kryerësit e mundshëm, qofshin ata, madje, edhe të profilit më të lartë politik. Përmbajtja e aktakuzës dhe emrat, që ceken në te, si dhe trysnia e opinionit publik për faktin se ka qenë fjala për gjykimin më të madh dhe më të rëndësishëm për krime të luftës në Kosovë pas luftës, nuk munden dhe guxojnë të jenë arsye për lëshime, të cilat mund t’ia heqin të drejtën të akuzuarve që të mbrohen dhe të drejtën e mbrojtjes që të jetë e barabartë me palën e prokurorisë para gjykatës. Me një vendim të këtillë, gjykata ka demonstruar superioritetin e ligjit mbi të gjithë dhe të askujt mbi ligjin. Vendimi i gjykatës, nga pikëpamja formale ligjore, madje, e ka rëndësinë e precedentit për Kosovën – ai duhet t’i shërbejë drejtësisë kosovare si model për respektimin e rregullave të barazisë së palëve dhe të gjykimin të ndershëm pa marrë parasysh se kush ndodhet në bankën e të akuzuarit e kush në atë të prokurorit. Rëndësia e këtij vendimi posaçërisht fiton në peshë kur të kihet parasysh se ai ka të bëjë me lëshimet në procedurën paraprake, në të cilën ritmin kryesor tradicionalisht e jep aktakuza, përkatësisht në të cilën mbrojtja luan rol pasiv.

FDH Kosovë dëshiron të theksojë se gjykata në asnjë moment nuk është futur në vlerësimin e bazueshmërisë së pohimeve nga deklaratat dhe provat me shkrim të “Dëshmitarit X” për shkak të lëshimeve procedurale me rastin e sigurimit të tyre. Në këtë mënyrë, ato nuk janë shpallur as të vërteta dhe as të pavërteta, por e papranueshme është shpallur mënyra se si është arritur deri te ato.



2. Gjykata, në mënyrë të saktë dhe pothuajse me saktësinë kirurgjike e ka zbatuar ligjin në rastin „Kleçka“. Megjithëkëtë, pas përfundimit të gjykimit të shkallës së parë, ky rast nuk është as edhe për një hap më afër vërtetimit të së vërtetës mbi atë që ka ndodhur në qendrën e paraburgimit në fshatin Kleçkë gjatë muajit prill të vitit 1999 si dhe ndriçimit të përgjegjësisë për këto ngjarje. Provat e tjera, posaçërisht ato nga zhvarrosja, të cilën në muajin shtator të vitit 2009 e ka kryer ekipi i ekspertëve të EULEX-it, kanë vërtetuar vdekjen e dhunshme të më së paku 8 personave, vrasja e të cilëve vihet në lidhje me qendrat e paraburgimit në Kleçkë. Për shkak të këtyre arsyeve, FDH Kosovë konsideron se në gjykimin e deritashëm në lëndën „Kleçka“ ka fituar ligjshmëria, por jo drejtësia. Që të kënaqet ajo, që familjet e viktimave të gjenin paqen, kurse gjyqësori kosovar të dëshmonte deri në fund se mund ta shpie përgjegjësinë edhe për krimet më të rënda të kryera gjatë luftës, rasti „Kleçka“ kërkon ndriçim deri në fund, konstatimin e kryerësve dhe përgjegjësinë e tyre penale në bazë të ligjit.

Vërejtjet e FDH Kosovë ndaj punës së gjykatës

1. Me rastin e shpalljes së vendimit të parë gjyqësor në datën 30.03.2012, me të cilin rasti „Kleçka“, në bazë nenit 385 të LPPK, është ndarë, kurse të akuzuarit Arben Krasniqi, Behlul Limaj, Refki Mazreku, Sabit Shala, Shaban Shala janë liruar nga përgjegjësia, gjykata, në një arsyetim të shkurtër, ka paralajmëruar se procedura lidhur me të akuzuarit e tjerë në krye me Fatmir Limajn vazhdon në drejtim të vërtetimit të përgjegjësisë komanduese. Gjykata, në këtë mënyrë, qartë e ka bërë me dije që vlerëson se provat e tjera në materialet e lëndës mund të shërbejnë si bazë për vazhdimin e hetimit në rastin „Kleçka“. Megjithëkëtë, me vendimin gjyqësor të datës 2.05.2012, gjykata i ka liruar Fatmir Limajn, Naser Krasniqin, Nexhmi Krasniqin dhe Naser Shalën nga të gjitha akuzat për krime të luftës, me të cilat i ka ngarkuar aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) e datës 25.07.2011. Përfundimi i këtillë ka paraqitur befasi, aq më shumë nga që gjykata në vendimin e dytë dhe përfundimtar, me të cilin është përfunduar procedura e shkallës së parë, fare nuk është futur në arsyetimin e vendimit që të mos e hap çështjen e përgjegjësisë komanduese të katër të dyshuarve pjesëtarë të rangut të lartë të ish UÇK-së¹³, që ka qenë në kundërshtim me paralajmërimin me rastin e komunikimit të vendimit të datës 30.03.2012. Gjykata, sipas ligjit, nuk është e obliguar me kualifikimin juridik të veprës, të cilin e ka dhënë prokurori. Si arsyetim nuk mund t'i shërbejë gjykatës edhe mosbashkëpunimi i prokurorisë, e cila, edhe pse ka pasur hapësirë për precizim të aktakuzës dhe përqendrim në drejtim të përgjegjësisë komanduese, nuk ka treguar aspak vullnet për këtë dhe ka vazhduar të ngul këmbë në aktakuzën e parë dhe shfuqizimin e vendimit të gjykatës mbi papranueshmërinë e provave të “Dëshmitarit X”.

¹³ Gjykata, madje, nuk e ka pranuar hapjen e diskutimit për këtë çështje, në të cilën ka ngulur këmbë mbrojtësi i Fatmir Limajt, avokati britanik Karim A.A. Khan).



Vendimi i këtitillë i trupit gjykues ka lënë përshtypje të keqe në udhëheqjen, në përgjithësi, shumë të mirë dhe kompetente të procesit gjyqësor në rastin „Kleçka“. Duke pasur parasysh se prokuroria ka paralajmëruar ankesë ndaj vendimit gjyqësor të shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë është e obliguar që tejet mirë të analizojë vendimin befases mbi përfundimin e procesit me lirim të katër të akuzuarve të tjerë pasi që gjykata e njëjtë paraprakisht, me rastin e analizës së lëndës, ka gjetur se ka bazë ligjore për vazhdim të seancës kryesore në lidhje me përgjegjësinë komanduese të katër të akuzuarve në pajtim me nenin 322, paragrafi 3 i LPPK, i cili kryetarit të trupit gjykues ia jep mundësinë që të sigurojë prova edhe pa propozimin e palëve.

2. Vërejtja e dytë thelbësore e FDH Kosovë ndaj punës së gjykatës ka të bëjë me vonesën e tij në shpalljen e vendimit të dytë gjyqësor të datës 2.05.2012, me të cilin Fatmir Limaj, Naser Krasniqi, Nexhmi Krasniqi dhe Naser Shala lirohen nga të gjitha akuzat për krime të luftës. Sipas gjetjeve të FDH Kosovë, gjykata e ka shpallur këtë vendim gjyqësor pas afatit të paraparë me ligj. Me fjalë të tjera, me nenin 392, paragrafi 1 i LPPK, qartazi parashihet që gjykata, pas përfundimit të procedurës penale, kryerjes së procedurës së dëshmisë dhe fjalëve përfundimtare, vendimin duhet ta shpallë në një afat jo më të gjatë se sa prej tri (3) ditësh. Veprimet e fundit procesorë janë shpallur në datën 30.03.2012 kur gjykata e ka sjellë vendimin mbi ndarjen e procedurës në lidhje me gjashtë prej tyre.

Kronologjia e rastit „Kleçka“

Procedura penale kundër Limajt dhe të tjerëve është nisur pasi që “Dëshmitari X”, si një nga aktorët e ngjarjeve të cilat gjatë konflikteve në Kosovë kanë ndodhur në qendrën e paraburgimit UÇK-së në Kleçkë, komuna e Lipjanit, në periudhën nga fillimi i vitit 1999 e deri në mesin muajit qershor, ka hyrë në kontakt me hetuesit e Njësisë së EULEX-it për hetim të krimeve të luftës në Kosovë në gjysmën e dytë të vitit 2009. Duke vepruar sipas kërkesës së prokurorit të datës 06.07.2010¹⁴, gjykatësi i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në datën 25.08. 2010 e ka dhënë urdhëresën mbi shpalljen e “Dëshmitarit X” të mbrojtur si dëshmitar bashkëpunues, në bazë të të cilit ndaj tij është ndërprerë procedura penale dhe shqiptimi i dënimit për veprat penale në kryerjen e të cilave, sipas fjalëve të tij, ka marrë pjesë në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë.

Pas hetimeve të kryera, të cilat i ka udhëhequr PSRK, në datën 25.07.2011 është ngritur aktakuza kundër dhjetë të akuzuarve, në krye me Fatmir Limajn, me të cilën të akuzuarit ngarkohen sipas shumë pikave për vepra penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile dhe për krime të luftës kundër të burgosurve të

¹⁴ Data nga arsyetimi i urdhëresës mbi shpalljen e dëshmitarit X dëshmitar bashkëpunues, sipas vendimit të kryetarit të trupit gjykues të datës 21.03.2012, prokurori, me kërkesën e cekur, i është drejtuar gjykatës në datën 19.08. 2010.



luftës. Aktakuza iu ka vënë në barrë se në cilësinë e pjesëtarëve ose të personave komandues të UÇK-së në qendrën e paraburgimit në fshatin Kleçkë, komuna e Lipjanit, kanë marrë pjesë në rrahjen, maltretimin, rrezikimin e integritetit fizik dhe të shëndetit të një numri të të burgosurve; se kanë marrë pjesë në vrasjen e të burgosurve, midis të cilëve edhe të policit Nebojsa Gjuriçiqit, dhe të civilëve Veljko Makoviçit, Arben Avdyilit, Bojan Cvetkoviçit, Zharko Filipoviçit, Zhivota Todoroviçit dhe të një numri të pidentifikuar të civilëve serb dhe shqiptar, të të paraburgosurve ushtarak dhe të burgosurve. Mbetjet mortore të viktimave të veçanta janë gjetur në varrezën masive në afërsi të fshatit Kleçkë.

Procedura e konfirmimit të aktakuzës, e cila në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ka zgjatur dy ditë, ka filluar në datën 24.08.2011 para gjykatësit të EULEX-it Ingo Risch. Procedura e konfirmimit kryesisht ka qenë e hapur për publikun, pos pjesës gjatë të cilës është bërë shikimi në zgjidhje të caktuara procedurale të procedurës paraprake. Aktakuza, si e pandryshuar, është konfirmuar me vendimin e datës 26.08.2011. Me vendim, të gjitha provat e prokurorisë, në të cilat është bazuar aktakuza, janë vlerësuar si të pranueshme. Gjykata ka konstatuar se ka mjaft prova, të cilat e mbështesin dyshimin themelor në lidhje me të gjitha akuzat kundër të gjithë të akuzuarve dhe se nuk ekzistojnë rrethana me të cilat do të përjashtohet përgjegjësia e tyre penale.

Pas konfirmimit të aktakuzës, në fazën e përgatitjeve për fillim të seancës kryesore, „Dëshmitari X“, në datën 28.09.2011, në rrethana të paqarta, ka kryer vetëvrasje në Gjermani.

Seanca kryesore pas aktakuzës së konfirmuar ka filluar në datën 11 nëntor të vitit 2011. Atëherë prokurori e ka ndryshuar aktakuzën, duke hequr dorë nga pika 2 në lidhje me të akuzuarin Arben Krasniqin. Pas leximit të aktakuzës, në seancën kryesore, të akuzuarit janë shprehur se nuk janë fajtor. Mbrojtja, në këtë rast, e ka propozuar edhe përjashtimin e prokurorit, gjë që është refuzuar, sepse trupi gjykues nuk është kompetent për trajtim lidhur me propozimin e tillë. Kryeprokurorja e EULEX-it, duke vepruar sipas kërkesës disa herë të përsëritur të mbrojtjes mbi përjashtimin e prokurorit Maurizio Salustro si dhe për thirrjen e tij në cilësi të dëshmitarit, me vendimin e datës 2.02.2012 i ka refuzuar kërkesat e mbrojtjes me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për përjashtimin e tij dhe dëgjimin tij në cilësi të dëshmitarit.

Gjatë seancës kryesore, e cila gjithsejtë i ka pasur 18 ditë të gjykimit, kryesisht janë shqyrtuar çështjet procedurale, propozimet e të akuzuarve dhe të mbrojtësve të tyre. Diskutimi i është kushtuar pranueshmërisë së provave kyçe, mbi të cilat është bazuar aktakuza, në deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues dhe në ditarin e tij, të cilin e ka mbajtur gjatë kohës së konfliktit të armatosur dhe kohës së qëndrimit të tij në Gjermani.

Pas shpalljes së vendimit mbi papranueshmërinë e deklaratave dhe të ditarit të “Dëshmitari X”, palët në procedurë gjatë vazhdimit të seancës kryesore të mbajtur në datën 21.03.2012 kanë arritur marrëveshjen që të provat e tjera të mbetura të prokurorisë të bashkëngjitura me aktakuzën të konsiderohen të lexuara



për procesverbal mbi seancën kryesore si dhe që palët, fjalët e tyre përfundimtare, t'ia parashtrojnë gjykatës në formën me shkrim, duke hequr dorë nga parashtrimi me gojë i fjalëve përfundimtare para trupit gjykues. Me vendim të veçantë të trupit gjykues të datës 21.03.2012 janë hequr të gjitha masat të cilat kanë qenë të shqiptuara për të akuzuarit, të akuzuarit të cilët janë ndodhur në paraburgim janë liruar nga paraburgimi si edhe të akuzuarit, të cilët janë ndodhur në arrest shtëpiak.

Prokurori, duke vepruar sipas kërkesës së trupit gjykues, në fjalën e tij të fundit me shkrim për trupin gjykues në formë të fjalës përfundimtare shumë të shkurtë nuk i ka elaboruar provat, por në gjithçka ka qëndruar pranë aktakuzës dhe provave, të cilat, me të njëjtën, ia ka dorëzuar gjykatës. Duke kërkuar nga gjykata për të shfuqizuar vendimin mbi shpalljen të papranueshme të provave të dëshmitarit bashkëpunues, të cilin e ka vlerësuar si të gabuar, prokurori ka vazhduar të ngul këmbë se provat ofrojnë mjaft baza që gjykata, në bazë të tyre, të sjell vendim me të cilin të gjithë të akuzuarit do të shpalleshin fajtor për vepra penale me të cilat ngarkohen me aktakuzë¹⁵ dhe, duke shprehur qëndrimin se mbetet në gjithçka lidhur me aktakuzën e parë, e cila, si e tillë, është konfirmuar nga ana e gjykatësit për konfirmimin e aktakuzës së Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, prokurori ka kumtuar se nuk dëshiron për ta modifikuar aktakuzën dhe as që gjykatës ti propozojë prova të reja dhe as të bëjë ndryshimin e kualifikimit të veprave penale të cilat të akuzuarve i vihen në barrë. Ai, po ashtu, ka thënë se nuk do të propozojë prova të reja dhe as që do të propozojë sigurimin e provave të reja. Të gjitha provat e propozuara, të cilat janë lexuar, sipas prokurorit, kanë qenë më se të mjaftueshme që të arrihet një vendim i ligjshëm dhe i drejtë i gjykatës në lidhje me përgjegjësinë penale të të katërve dhe të të gjithëve, të dhjetë të akuzuarve.

Mbrojtësit e të akuzuarve, në fjalët e tyre përfundimtare, kanë potencuar se prokurori, në situatën në të cilën ndodhet, kur prova kyçe mbi të cilën është bazuar aktakuza është shpallur e papranueshme, është dashur të heq dorë plotësisht nga e njëjta. Mbrojtësit, në propozimet e tyre, në pajtim me nenin 390, paragrafi 3, kanë kërkuar nga gjykata që të akuzuarit t'i lirojnë nga aktakuza, sepse nuk është provuar se ata kanë kryer vepra penale, me të cilat janë ngarkuar.

Të gjithë të akuzuarit, duke vepruar sipas urdhrit të gjykatës, i kanë pranuar fjalët përfundimtare të mbrojtësve të tyre dhe i kanë vërtetuar me nënshkrimet e tyre me shkrim para se t'ia dorëzojnë gjykatës, gjë që është konstatuar nga ana e trupit gjykues të mbajtur në datën 30.03.2012.

Pas sigurimit të fjalëve përfundimtare të palëve, trupi gjykues ka shpallur vendimin gjyqësor, me të cilin Limaj dhe tre të akuzuarit e tjerë lirohen nga të gjitha akuzat e aktakuzës së datës 25.07.2011. Me këtë,

¹⁵ Një pjesë të fjalës përfundimtare të prokurorit, Kryetari i trupit gjykues e ka lexuar gjatë seancës gjyqësore të mbajtur në datën 30.03.2012 me vërejtjen se prokurori nuk ka vepruar sipas udhëzimit obligues të gjykatës për ta precizuar aktakuzën ekzistuese.



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

seanca gjyqësore e shkallës së parë në rastin „Kleçka“ ka përfunduar¹⁶. Prokuroria ka paralajmëruar ankesa ndaj vendimit të gjykatës.

¹⁶ FDH Kosovë nuk ka informacion mbi komunikimin e mundshëm, me çka e ruan të drejtën e përditësimit të qëndrimeve të veta pas sigurimit të informacionit ose vendimit të arsyetuar gjyqësor, pos vendimit mbi pranueshmërinë e deklaratave që kanë të bëjnë me shikimin e kryer në vitin 2009 në vendin kritik.